

**V E N D I M**

**Nr. 13 Datë 28/01/ 2008**

**PËR**

**DHËNIEN E LIÇENSËS PËR NDERTIM, INSTALIM DHE SHFRYTEZIM TE CENTRALEVE ELEKTRIK ME ERE SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE, SHOQERISË “ALB WIND ENERGY” SH.P.K PER PROJEKTET VISU DHE TERPAN**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9072 dt.22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, germa a, si dhe Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr. 21, datë 04.04.2007 “Per Miratimin e Rregullores për Procedurat e Licensimit”, neni 11, pika 1, neni 13, pika 1 dhe 2, Vendimit Nr. 44, datë 24.07.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të dt 28/01/2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “ALB Wind Energy” sh.p.k për marrje licënsë për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik me erë si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale,


**Vendosi:**

I- Dhënie e licënsës shoqërisë “ALB Wind Energy” shpk në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike për projektet VISU me fuqi 140 MW, dhe projekti TERPAN me fuqi 85 MW, duke plotësuar kushtet e mëposhtëme:

1. Brenda një afati kohor 12 mujor të realizojë:
  - Sigurimin e dokumentave të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave me institucionet shtetërore apo me subjektet private, për huapërdorje ose qeramarrje, për të gjithë sipërfaqen e nevojëshme për realizimin e projektit.
  - Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



studim të paraqitët në ERE përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

2. Shoqëria “ALB Wind Energy” shpk duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nenshkruar me OST sh.a. përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuar detyrimet e ndërsjellta, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.
3. Shoqëria “ALB Wind Energy” shpk, do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
4. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke ju referuar datës së leshimit të licencës të jetë 36 muaj.


II- Afati i vlefshmërisë së licensës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



Votimi për :

**V E N D I M I N**

Nr. 13 Datë 28/01/ 2008

**PËR**

**DHËNIEN E LIÇENSËS PËR NDERTIM, INSTALIM DHE SHFRYTEZIM TE CENTRALEVE ELEKTRIK ME ERE SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA KETO CENTRALE, SHOQERISË "ALB WIND ENERGY" SH.P.K PER PROJEKTET VISU DHE TERPAN**

Anëtarët e Bordit	Votimi	
	Pro	Kundër
1. Bujar Nepravishta	_____	_____
2. Petrit Ahmeti	_____	_____
3. Adriatik Bego	_____	_____
4. Entela Shehaj	_____	_____
5. Ardian Hacı	_____	_____